



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Politikën e Jashtme*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.04.2022, ora 11:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit 18 prill–6 maj 2022 dhe i programit të punës 18 prill–27 maj 2022.
2. Miratimi i procesverbalit të komisionit për datat 18 shkurt 2022; 2, 7 dhe 9 mars 2022.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës”. (*Komision për dhënie mendimi*)
4. Projektligji “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për programin “UKT Shpërndarja e Ujit”. (*Komision për dhënie mendimi*)
5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për një hua të bazuar në politika për mbështetjen e barazisë gjinore në aksesin ndaj mundësive ekonomike në Shqipëri”. (*Komision për dhënie mendimi*)
6. Projektligji “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumente zyrtare”. (*Komision për dhënie mendimi*)
7. Akti normativ nr.6, datë 18.3.2022 “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkuara (amendimi i tretë) në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet Pfizer Export

B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrin të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr.3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar”. (Komision për dhënie mendimi)

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krrashi, Petro Koçi, Tritan Shehu, Klodiana Spahiu, Pandeli Majko, Etilda Gjonaj, Taulant Balla, Bardhyl Kollçaku dhe Grida Duma.

**Mungojnë:**

Tomor Alizoti, Greta Bardeli, Shpëtim Idrizi, Vangjel Dule, Belind Këlliçi dhe Kreshnik Çollaku.

**Të ftuar:**

Kesjana Halili – Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Idlir Gjata – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Gjergj Simaku - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Rudina Xhelilaj – Drejtore e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë

Fatos Bundo - Drejtor i Njësisë së Menaxhimit të Projekteve për Sigurinë e Digave (KESH sh.a)

Ermal Nuri - Drejtor i Departamentit të Gjenerimit (KESH)

Arbjan Mazniku - Nënkryetar i Bashkisë së Tiranës

Elton Kacidhja - Drejtor i Përgjithshëm i UKT-ës

Henrik Hysenbegasi - Drejtor në Drejtorinë e Implementimit të Investimeve të Huaja

Elona Mistrovica – Drejtore e Drejtorisë së Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj

Olta Manjani – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Albin Gega – Drejtor i Drejtorisë së Punësimit dhe Aftësimit Profesional

Evis Fico - Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Adea Pirdeni - Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit

Vjollca Braho - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Eugena Tomini – Drejtore e Institutit të Shëndetit Publik

Mejvis Kola – Drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrera – Drejtore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëdita!

Ju kërkoj ndjesë për vonesën, shkaku i së cilës ishte mbledhja e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste!

Pa humbur kohë, le të fillojmë mbledhjen e datës 19.4.2022 të Komisionit për Politikën e Jashtme.

Në rendin e ditës kemi disa çështje për të diskutuar, të cilat po i citoj me radhë: miratimi i kalendarit të punës së komisionit 18 prill–6 maj 2022 dhe i programit të punës 18 prill–27 maj 2022, të cilin, nëse jeni dakord, e konsideroj të miratuar; miratimi i procesverbalit të komisionit për datat 18 shkurt 2022, 2, 7 dhe 9 mars 2022, të cilin, nëse nuk ka vërejtje, e konsideroj të miratuar.

Para se të fillojmë diskutimin e projektligjeve, më lejoni që, në emrin tuaj, t’u uroj mirëseardhjen dy anëtarëve të rinj të Komisionit për Politikën e Jashtme, ish-ministrit Majko dhe ish-ministres Gjonaj! Besoj se me ardhjen tuaj komisioni jo vetëm do të vazhdojë të jetë në nivelin e cilësisë që i takon, por më mirë akoma, do të kemi një bashkëpunim dhe aktivizim më të ndjerë të të gjitha diskutimeve që kalojnë në këtë komision dhe të çështjeve me të cilat merret ky komision.

Vazhdojmë më tutje.

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës”. Komision ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Krrashi.

Të ftuar për këtë projektligj janë: zonja Halili, drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, zonja Mistrovica, drejtore e Drejtorisë së Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj, zoti Gjata, këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, zoti Simaku, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Rudina Xhelilaj, drejtore e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë, zoti Bundo, drejtor i Njësisë së

Menaxhimit të Projekteve për Sigurinë e Digave në KESH, si dhe zoti Nuri, drejtor i Departamentit të Gjenerimit në KESH.

Fillojmë pa humbur kohë.

Kush nga zotërinjtë e ftuar do ta marrë fjalën i pari? Ju, zoti zëvendësministër?

Fjala për ju.

**Gjergj Simaku** – Faleminderit, zonja kryetare!

Dëshiroj t'ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë miratim që po bëni për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet KESH-it, Ministrisë së Financave dhe KfW-ës për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës! Rehabilitimi i agregateve të Fierzës ka qenë një çështje tepër urgjente, sepse ato kanë përbërë një punë të jashtëzakonshme gjatë 39 vjetëve dhe duhet thënë që çdo ditë ato bien pafundësisht, duke shkaktuar humbje të mëdha, të paktën 4% të prodhimit të energjisë nga Fierza. Këto agregate janë riparuar gjatë gjithë kohës nga ana e Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, por tashmë kanë plotësuar dhe kohën e tyre të punës dhe po mendojmë të rehabilitojmë pjesërisht turbinat, lopatat, gjeneratorët, të cilët ndodhen në objektin e Fierzës, si të thuash, në shtëpinë e prodhimit të energjisë në Fierzë.

Kuptohet që Fierza është një nga kolosët e kaskadës së Drinit. Ajo prodhon të paktën 1,6 terravat/orë mesatarisht në çdo vit energji elektrike dhe përbën një nga prodhuesit më të mëdhenj të energjisë, por sidomos një nga ujëmbajtësit më të mëdhenj të kaskadës. Niveli i Fierzës përcakton edhe zhvillimet e mëtejshme të prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri.

Do të thosha që, për çështje të sigurisë së Fierzës, ne dëshirojmë që kjo marrëveshje të miratohet, të kalojë brenda këtij komisioni, sepse është jashtëzakonisht urgjent rehabilitimi i këtyre agregateve. Më në fund ka ardhur rehabilitimi i agregateve mekanike dhe elektro-mekanike, të cilat janë zemra e hidrocentralit të Fierzës.

Huaja është prej 40 milionë eurosh, të cilat janë ratifikuar së bashku me KfW-në nëpërmjet bisedimeve të njëpasnjëshme, janë përcaktuar termat, projektet që do të bëhen, palët që do të marrin pjesë dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me rehabilitimin e këtij hidrocentrali.

Përfitimet nga rehabilitimi i këtij hidrocentrali në dukje nuk janë shumë të mëdha. Prodhimi rritet me 4%, por pritshmëritë janë që, me hapjen e turbinave, të vendoset një teknologji e re e vendosjes së lopatave, e cila do ta rrisë në mënyrë të ndjeshme eficiencën e prodhimit të energjisë brenda në turbinë dhe kjo do të bëhet pasi ato të dalin, pra pas afro 40 vjetësh ne do të shohim lopatat e turbinës dhe do të kemi një rimodelim të tyre, çka është e

parashikuar brenda kësaj shume. Gjithashtu, teknologjia gjermane na ka ofruar edhe mundësi të tjera të këtij rehabilitimi, për të parë hap pas hapi se çfarë po ndodh.

Kështu që me një skenar, si të thuash, pak të rezervuar, ne do të rrisim prodhimin e kaskadës me 53 gigavat/orë, pra me 53 mijë megavat/orë në vit për këtë kaskadë; do të rritet prodhimi i Fierzës me 4%, si dhe do të kemi dhe kontribute të reduktimit të CO2-shit, nëse këto sasi do të importohen, siç janë importuar deri në fund.

Për termat financiare për të cilët qoftë Korporata Elektroenergjetike, qoftë Ministria e Financave kanë kryer negociata me KfW-në, mendoj t'ia jap fjalën zonjës për t'i shpjeguar më tutje këto çështje.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Po, zonja Halili.

**Kesjana Halili** – Përshëndetje, të nderuar!

Sikurse e tha zoti zëvendësministër, kredia është në shumën 40 milionë euro. Ndërkohë, interesi do të përcaktohet në momentin e disbursimit të kësaj kredie dhe është marzhi prej 0,55% mbi normën referencë, që është IKAP-euro, e cila aktualisht në tregjet ndërkombëtare është 1,2%. Gjithashtu, kjo kredi shoqërohet dhe me një tarifë menaxhimi, që është 1% e shumës së huas, pra është një shumë ku paguhet 1% e të gjithë 40 milionë euroshit në momentin e disbursimit. Ka dhe një komision angazhimi, që është 0,25% në vit mbi shumën e padisbursuar të huas.

Maturiteti është 26 vjet, ku 6 vjet janë pa pagesë principali.

Kjo hua është e përfshirë në programin buxhetor afatmesëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zonjë!

A ka pyetje, kolegë? Shikoj që kolegët nuk kanë asnjë pyetje. Unë kam dy pyetje, por më parë do të relatojë zoti Krrashi.

Faleminderit!

**Lavdrim Krrashi** – Faleminderit për përshkrimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e

zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës”.

Do të flas shumë shkurt.

Sipas prezantimit tuaj dhe sipas dokumentacionit që na është paraqitur, duket se kemi “bëj asgjë vs bëj atë që duhet bërë”. Pra, nëse ne vazhdojmë të mos rehabilitojmë hidrocentralin e Fierzës, i cili është hidrocentrali më i rëndësishëm sot për sot në kaskadën e Drinit, atëherë konsekuencat do të jenë shumë të mëdha jo vetëm thjesht në aspektin energjetik, por edhe në aspektin e sigurisë, të zhvillimit social e ekonomik të vendit dhe në shumë aspekte të tjera.

Prandaj, duke e parë në tërësi, mendoj se është e udhës t’u kërkoj të gjithë kolegëve të Komisionit për Punët e Jashtme, i cili është vetëm komision për dhënie mendimi dhe nuk është komision përgjegjës, duke pasur parasysh edhe arsyet se përse bëhet kjo, pra “bëj atë që duhet vs mos bëj asgjë” ose një mënyrë tjetër e të shprehurit do të ishte: “Shpenzo tani, për të kursyer në të ardhmen”, ta ratifikojmë marrëveshjen për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës.

Shifrat i kemi parë të gjitha. Në fakt, është një hua me kushte shumë favorizuese, për të mos hyrë në luftën e shifrave.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, koleg!

A ka pyetje?

Atëherë, po i lejoj vetes të bëj dy pyetje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Si të doni, zoti Etjen.

A ka pasur një skedulim të mëparshëm të rehabilitimit të elementeve të caktuara të hidrocentralit?

Me të drejtë, ju thatë që pas 40 vjetësh do të ndërhyhet në mënyrë serioze në disa elemente, nuk di të them teknikisht, fletët e turbinave apo diçka tjetër që ju keni gjykuar se duhen ndërruar. A ka pasur një skedulim, i cili nuk është zbatuar për arsye të ndryshme dhe pse bëhet sot? Kjo është e para.

E dyta, me të drejtë, ju thoni në kushtet e kontratës, te kërkesat për disbursim, që sapo të krijohen të gjitha kushtet e paradisbursimit do të fillohet me disbursimin. Cilat janë kushtet e paradisbursimit? Nëse këto kushte nuk zbatohen, çfarë ndodh?

Fjalën e ka kolegu Xhafaj dhe më pas kolegu Krrashi.

**Etjen Xhafaj** – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zëvendësministër!

Pas dy pyetjeve që bëri kryetarja e komisionit, kam edhe unë një pyetje, që lidhjet drejtpërdrejt me to.

Së pari, sa janë afatet që do të zgjasë ky riparim nga ana teknike?

Së dyti, a do të ketë kjo impakt, qoftë dhe kanalizim, pra planifikim të këtyre ndërhyrjeve për të mos krijuar problematikë sa i përket furnizimit me energji të prodhuar nga kjo kaskadë?

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Krrashi? Jo.

**Fatos Bundo** – Përshëndetje!

Për sa i përket pyetjes së parë, në HEC-in e Fierzës realizohen gjithmonë rehabilitime pjesore çdo vit, por nuk mund të ndodhë asnjëherë të bëhet rehabilitim shumë i thellësishëm, sepse është i domosdoshëm zmontimi i turbinës, që na kushton shumë në prodhimin e energjisë. Çdo vit ka mirëmbajtje rutinë dhe këto skedule janë të zbatueshme, sepse ka një rregullore në KESH, ku përcaktohen afatet dhe koha kur duhet të bëhet ky proces mirëmbajtjeje...

*(Zonja Mimi Kodheli ndërhyr pa mikrofon.)*

Patjetër, çdo ndërhyrje që bëhet është nga 30 deri në 40 vjet kohë operimi.

Kushtet e disbursimit lidhen me firmosjen e kontratës, me kontraktorin që do të bëjë zbatimet, me dhënien e sheshit të ndërtimit, siç quhet, por sheshit të demontimit, si dhe me pagesën *advance* (pra, në momentin kur ne lidhim kontratën, jemi të detyruar të paguajmë 10% ose 15%, sipas marrëveshjes që do të bëjmë me KfW-në) dhe këto janë tri kushtet ku kontraktori fillon dhe faturon. Pa u realizuar këto tri kushte nuk mund të kemi disbursim.

Për sa i takon afatit të rehabilitimit, është parashikuar 5 vjet, sepse, siç e tha dhe zoti Etjen, ne nuk mund t'i hapim të katra turbinat në të njëjtën kohë, sepse kemi nevojë të prodhojmë energji. Kështu që periudha e rehabilitimit të një turbine shkon nga 12 deri në 16 muaj. Ju duhet të keni në konsideratë që është një avari shumë e madhe: montohet, zmontohet, pjesët dërgohen jashtë shtetit dhe atëherë mësohet dhe natyra e ndërhyrjes, sepse në momentin kur turbina është në punë, çfarëdo ekspertize të dërgojmë ne, nuk arrin në detaje për të parë shkallën e dëmtimit të tyre, por duke pasur dhe trendin e... Ne kemi një eksperiencë të mirë, sepse u rehabilituan katër turbinat e Komanit. Kjo periudhë rehabilitim përkon nga 12-16 muaj.



Mbaron turbina e parë, fillon turbina e dytë e me radhë dhe kjo shkakton afatin prej 5 vjetësh të rehabilitimit të të katra turbinave në Fierzë.

**Mimi Kodheli** – Kam edhe një pyetje.

Zëvendësministri tha që prodhimi do të rritet më 4% pas rehabilitimit. Kur do të fillojë të ndodhë kjo, pasi të jenë rehabilituar të gjitha turbinat?

**Fatos Bundo** – Jo. Ju duhet të kuptoni që për rrotat e punës, aty ku godet uji, po e shpjegoj pak më thjeshtë, dhe pastaj transmeton lëvizjet e rrotullimit, shumë kohë më parë, në vitet '70, ka qenë një teknologji e vjetër. Sot modelimet kanë treguar se ndryshimi i këndit të atyre fletëve, kini parasysh...

*(Zonja Mimi Kodheli ndërhyr pa mikrofon.)*

Jo, nuk prodhon më shumë turbina, por për sasi uji të njëjtë ne prodhojmë energji më shumë. Pra, ne kursejmë ujë më shumë. Ky modelim është realizuar tashmë dhe ne po presim që këto dy rrotat e punës, që do të zëvendësohen për turbinat nr.1 dhe nr.3, sepse turbinat nr.2 dhe nr.4 janë zëvendësuar në vitin '85, do të rrisin një kapacitet 10%. Duke marrë në konsideratë që janë 4 turbina, atëherë ne e shpërndajmë dhe i bie mesatarisht 5%, por kemi qenë pak të kujdesshëm dhe themi që rritja e eficiencës do të jetë 4% dhe kjo është e sigurt.

Modelimet tashmë janë bërë, janë përshkruar në specifikimet teknike dhe kontraktori është i detyruar që, rrotat e punës për turbinat nr.1 dhe nr.3, t'i sjellë sipas rimodelimeve të reja. Kjo do të thotë se këto dy turbina do të kenë eficiencë energjie shumë herë më të madhe.

**Mimi Kodheli** – Ju falënderoj për sqarimet!

Ftoj kolegët, por edhe qeverinë që, nëse do të ketë ndryshime buxhetore deri në fund të vitit, kjo të mos ketë të bëjë fare pikërisht me këtë sektor, duke e konsideruar këtë si një sektor jetik, sidomos në kushtet kur prodhimi i energjisë nga burime të tjera bëhet gjithnjë e më i vështirë, për shkaqe gjeopolitike.

Kështu që ju falënderoj edhe një herë për prezencën dhe për sqarimet!

Nëse nuk ka ndonjë koment apo ndonjë pyetje tjetër, kolegë, e hedhim në votim projektligjin. Kush është dakord me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH, agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës”?

Jemi komision për dhënie mendimi.

Kush është dakord me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi.

E konsideroj të miratuar pa vota kundër dhe pa abstenime

Faleminderit, kolegë, për prezencën!

Punë të mbarë!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Politikën e Jashtme*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 19.04.2022, ora 11:10

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumente zyrtare”.

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krrashi, Petro Koçi, Tritan Shehu, Klodiana Spahiu, Pandeli Majko, Etilda Gjonaj, Taulant Balla, Bardhyl Kollçaku, Grida Duma.

**Mungojnë:**

Tomor Alizoti, Greta Bardeli, Shpëtim Idrizi, Vangjel Dule, Belind Këlliçi, Kreshnik Çollaku,

**Të ftuar:**

Adea Pirdeni – Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

**Mimi Kodheli** – Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumente zyrtare”.

Jemi komision për dhënie mendimi.

Relaton kolegu Klosi.

Për pikën 6 kemi kënaqësinë të rikemi zonjën Pirdeni, zëvendësministre e Drejtësisë.

Mirë se vjen, zëvendësministre!

Kemi kënaqësinë të rikemi zotin Beja, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Mirë se vjen, drejtor!

Zonja Zëvendësministre, fjala për ju.

**Adea Pirdeni** – Faleminderit, e nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Sot ju paraqitet për shqyrtim projektligji “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumente zyrtare”” ose, ndryshe, konventa nr. 205/2009.

Konventa përfaqëson të parin akt ndërkombëtar të dedikuar posaçërisht të drejtës për akses në dokumentet zyrtare, si një instrument thelbësor i pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisje, si një shprehje e ushtrimit efektiv të demokracisë përfaqësuese.

Konventa nr. 205/2009 e Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumente zyrtare” nënshkruar në Tromso, në datën 18.06.2009, vendos standarde minimale që duhen zbatuar në shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare duke u lënë mundësi shteteve që të zgjerojnë mundësitë e aksesit tej këtij minimumi përmes kuadrit të tyre të brendshëm ligjor.

Miratimi i këtij projektakti e plotëson dhe zhvillon më tej kuadrin ligjor shqiptar për të drejtën e informimit, e drejtë e cila sanksionohet në nenin 23 të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Konventa në fjalë plotëson kuadrin ligjor të brendshëm për të drejtën e informimit duke garantuar akses të plotë në dokumente zyrtare, natyrisht, në përputhje me kufizimet e parashikuara në këtë konventë, kufizime, të cilat lejohen për mbrojtjen e interesave të caktuara, si siguria kombëtare, mbrojtja e privacisë e të tjera.

Nga pikëpamja procedurale, konventa është miratuar në parim me VKM-në nr. 1123, datë 30.12.2020, për miratimin në parim të konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare” dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i përhershëm në misionin e

përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Europës, ambasadori, zoti Dastid Koreshi, datë 28.01.2022.

Ky projektligj, gjithashtu, ka kaluar përgjatë gjithë procesit të konsultimit të projektakteve me institucionet përgjegjëse.

Projektligji përmban 3 nene. Në nenin 2 parashikohet se në nenin 12, pika 1 të konventës të Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare” Republika e Shqipërisë cakton Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si përfaqësues në këshillin e palëve.

Ky parashikim vjen edhe në vijim të komentit të kryer nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit për shtimin e këtij parashikimi, me shkresën me nr. protokolli 407/1, datë 24.02.2022, i cili shfaqet edhe në cilësinë e institucionit përgjegjës për sigurimin e implementimit dhe zbatimit të konventës, nisur nga fusha e veprimtarisë shtetërore që mbulon.

Së fundi, përmes këtij projektligji synohet të rritet efektiviteti i zbatimit të së drejtës për akses në dokumentet zyrtare, me qëllim nxitjen e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike, integritetin në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe garantimin e mirëqeverisjes në tërësi. Natyrisht, mbetemi në dispozicion të anëtarëve të nderuar të këtij komisioni për çdo pyetje ose koment që çmohet me vlerë në lidhje me këtë projektakt.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, Zëvendësministre!

Fjala për ministrin Klosi.

**Blendi Klosi** – Faleminderit, kryetare!

Ashtu siç e tha edhe zonja zëvendësministre me shumë korrektesë, projektligji vjen në përputhje me një marrëveshje që tashmë qeveria shqiptare, nëpërmjet ambasadës sonë, ka nënshkruar me Këshillin e Europës për aksesin në dokumentet zyrtarë. Është pjesë e politikës që po ndjekin të gjitha vendet e Këshillit të Europës për të rritur transparencën e dokumenteve zyrtare për ta shtuar gjithnjë e më shumë informimin e qytetarëve në dokumentet, me të cilat shteti punon.

Në fakt, në këtë kuadër, Shqipëria do të duhet të vlerësohet për punën e madhe që ka bërë për t’i përputhur këto dokumente me dokumentet e vendeve anëtare të Këshillit European, po ashtu edhe me politikat e saj të brendshme, ku gjithnjë e më shumë aksesin në dokumentet zyrtare,

përqasja karshi opinionit publik, natyrisht, edhe vlerësimi i të gjithë opinionit dhe kërkesave që vijnë nga të gjithë aktorët, duke përfshirë këtu opozitën parlamentare, po ashtu edhe institucionet e shoqërisë civile, që duan akses në dokumentet zyrtarë, besoj se do të duhej të shënojë një nga ato vende ku transparenca dhe hapësira publike është gjithmonë e madhe për ata që duan informacion.

Po ashtu, edhe parlamenti shqiptar, në kuadër të komisioneve dhe jetës së tij të brendshme, punon gjithmonë e më shumë për të rritur transparencën institucionale të vendimmarrjes, dhe këtu vlerësoj punën e bërë nga instituti për transparencën parlamentare që drejtohet nga kolegja Gjonaj dhe ne po përpiqemi që jeta parlamentare të jetë gjithmonë e hapur. E futa këtë si intermexo për të dhënë një shembull të qartë se edhe parlamenti shqiptar po bëhet gjithnjë e më shumë transparent për çdo gjë dhe besoj se nuk ka pasur asnjë ngjarje apo detaj, ku ne të kemi një kërkesë nga një përfaqësuesi i shoqërisë civile apo i grupit opozitar që të mos të ketë marrë përgjigjen korrekte brenda rregullave dhe parimeve, mbi të cilat ndërtohet administrata publike.

Unë i ftoj kolegët të pranojnë dakordësinë me këtë projektligj, i cili shënon një hap përpara në përmbushjen e detyrimeve që kemi ne, në raport me qenien me të drejta të plota dhe tashmë si një shtet aktiv në të gjithë vendimmarrjen e Këshillit të Europës.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, Ministër!

A ka pyetje? Komente?

Nëse nuk kemi as pyetje dhe as komente, unë dua ta falënderoj zëvendësministren dhe drejtorin për prezencën! Ju falënderoj për seriozitetin me të cilin prezantoni këtu projektligjin. Gjithashtu, falënderoj edhe kolegët, si kolegun Klosi për relatimin.

Gjykoj se duhet hedhur në votim.

Kush është dakord me projektligjin “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare””?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E votojmë projektligjin në tërësi.

E konsideroj të miratuar pa vota kundër dhe pa abstenime.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 19.04.2022, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Akt normativ nr. 6, datë 18.03.2022 “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkuara (amendimi i tretë) në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar.” (*Komision për dhënie mendimi.*)

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krrashi, Petro Koçi, Tritan Shehu, Klodiana Spahiu, Pandeli Majko, Etilda Gjonaj, Taulant Balla, Bardhyl Kollçaku, Grida Duma.

**Mungojnë:**

Tomor Alizoti, Greta Bardeli, Shpëtim Idrizi, Vangjel Dule, Belind Këllici, Kreshnik Çollaku.

**Të ftuar:**

Vjollca Braho – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Eugena Tomini – Drejtoreshë e Institutit të Shëndetit Publik  
Mejvis Kola – Drejtoreshë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Antoneta Njehrrrena – Drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



**Mimi Kodheli** – Kalojmë te pika 7: akti normativ nr. 6, datë 18.3.2022 “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkuara (amendimi i tretë) në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar”.

Jemi komision për dhënie mendimi. Ky akt normativ rikthehet në komisionin tonë, meqenëse kemi qenë komision për dhënie mendimi në momentin kur marrëveshja me kompaninë “Pfizer” është realizuar për herë të parë.

Falënderojmë kolegjen Spahiu për prezencën, pasi ka lënë me nxitim komisionin tjetër!

Normalisht, doktoresha duhej të ishte prezente në diskutimin e këtij akti normativ, megjithëse akti normativ vjen vetëm për arsye të kërkesës që kompania Pfizer ka për t’u risjellë edhe një herë në diskutim pa pasur asnjë ndryshim në kontratë, me sa kam kuptuar.

I falënderoj zonjat prezent që janë të ftuara!

Ju citoj: zonja Braho, zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonja Tomini, drejtore e Institutit të Shëndetit Publik, zonja Kola dhe zonja Njehrrrena, respektivisht, drejtoresha.

Mirë se keni ardhur!

Ju falënderoj edhe prezencën tuaj me maskë, gjë që e vlerësoj në mënyrë eksplicite.

Urdhëroni, zonja Zëvendësministre!

**Vjollca Braho** – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Kemi sjellë sot për miratim marrëveshjen midis Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “Pfizer” për blerjen e 1 milion dozave të reja për vitin 2022 dhe 500 mijë doza për vitin 2023.

Sigurisht, ne e kemi kaluar në të gjitha komisionet pjesën e miratuar të tekstit të marrëveshjes dhe ajo është miratuar nga të gjitha komisionet, duke u kryesuar nga Komisioni i Shëndetësisë. Njëkohësisht, është firmosur kjo marrëveshje edhe nga qeveria shqiptare, edhe nga kompania “Pfizer”, por procedura e kërkon që të miratohet marrëveshja pas firmosjes.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje sigurohet blerja e 1 milion vaksinave nëpërmjet një kalendari të mirëpërcaktuar.

Deri në fund të pranverës do të vijnë 300 mijë dozat e para. Në qershor do të vijnë 200 mijë doza, në shtator 200 mijë doza të tjera dhe deri në fund të 3-mujorit të katërt do të vijnë edhe 300 mijë doza, që kompletojnë pjesën e 1 milion dozave për vitin 2022.

Në qoftë se dëshironi, unë mund të jap edhe disa të dhëna për sa i përket procesit të vaksinimit: se sa doza kanë ardhur gjithsej, sa janë aplikuar.

**Mimi Kodheli** – Do t'ju lutesha që të na i jepni këto të dhëna, sepse në këtë mënyrë bëjmë edhe një sensibilizim dhe një rithirje për të gjithë ata që nuk janë vaksinuar, që mund dhe duhet të vaksinohen!

**Vjollca Braho** – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke filluar që në momentin e parë, në datën 11 janar të vitit 2021, kur ka filluar procesi i vaksinimit, deri tani në Shqipëri kanë ardhur në total 3 141 630 doza të vaksinës ndaj COVID-19, ndërsa për sa i përket procesit të administrimit nga ana jonë, kemi administruar deri tani 85% të këtyre dozave të ardhura. Në total numri i dozave të aplikuara është 2 796 648 doza gjithsej, nga të cilat doza të para janë 1 287 820, doza të dyta janë aplikuar 1 224 776 dhe doza të treta kanë aplikuar 284 052 doza.

Për sa i përket mbulesës vaksinale të popullsisë target mbi 16 vjeç, jemi në masën 60,8% me një dozë, 56,9% me dy doza dhe 11,6% me tri doza.

Gjithashtu, vjen të theksohet se është bërë një punë e madhe edhe nga ana e Institutit të Shëndetit Publik dhe operatori për t'i sensibilizuar të gjithë qytetarët për t'u vaksinuar (ato që kanë mbetur pa u vaksinuar), duke filluar me mjekun e familjes dhe Institutin e Shëndetit Publik.

Që nga fillimi i procesit të vaksinimit dhe me mbulesën vaksinale të popullatës target mbi 16 vjeç, 60,8% është mbulesa vaksinale me një dozë, 56,9% me dy doza dhe 11,6% me tri doza.

Për sa i përket mbulesës vaksinale për të gjithë popullsinë nga 0-100 vjeç kemi mbulesë vaksinale 49% me një dozë, 45,8% me dy doza dhe 9,3% me tri doza.

Sigurisht, miratimi i marrëveshjes së sotme do të bëjë të mundur vazhdimin e procesit të vaksinimit për ato që do të vaksinohen me dozën e dytë ose me dozën e tretë, sigurisht, edhe për atë pjesë të popullatës që nuk është vaksinuar.

E falënderoj komisionin tuaj për mbështetjen që na jepni në miratimin e kësaj marrëveshjeje, njëkohësisht, për thirrjen që u bëhet qytetarëve që nuk janë vaksinuar për ta kryer vaksinimin, sepse është një mbrojtje shumë e madhe.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, Zëvendësministre!

Urdhëroni, doktoreshë Spahiu!

**Klodiana Spahiu** – Faleminderit, kryetare!

Të nderuar të ftuar,

Pas prezantimit që bëri zonja zëvendësministre, mua më mbetet pak për të shtuar.

Meqenëse Komisioni i Shëndetësisë ka qenë komision përgjegjës për të gjitha aktet normative, doja të theksoja se në këtë akt normativ, përveç faktit që është sasia që do të mbulojë Shqipërinë për vitin 2021 dhe 2022, duhen përmendur edhe disa pika të tjera të marrëveshjes ku nënkuptohet që “Pfizeri” duhet të sigurohet që i gjithë produkti të jetë i etiketuar, i paketuar siç duhet, në përputhje me autorizimin.

Tri pika të rëndësishme që përmenden në marrëveshje janë, përveç sasisë së furnizimit, edhe përkufizimi i vaksinës pediatrike, ku ne kemi pasur vështirësi, sepse numri i të vaksinuarve në moshën pediatrike është pak i vogël. Unë do të bëja një propozim që, ndoshta, edhe grupi “Miqtë e fëmijëve” duhet të llojë pak në lidhje me rritjen e shkallës së vaksinimit. Përveç punës që bëjnë Instituti i Shëndetit Publik dhe Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, na takon edhe neve si deputetë të bëjmë pjesën tonë, sepse e dimë që vjen shtatori përsëri dhe numri i rasteve detyrimisht, duke qenë viruse të ndryshme që modifikohen, mund edhe të rritet, prandaj ky do të jetë një proces vaksinimi që do të vazhdojë dhe do të përsëritet.

E dimë shumë mirë që vende të tjera kanë filluar dhe janë të përgatitur për vaksinën e katërt, prandaj edhe ne duhet të kemi një lloj nxitjeje dhe stimuli të përbashkët për të nxitur procesin e vaksinimit.

Ka një lloj rënie të numrit të vaksinimit edhe për shkak të faktit se njerëzit shohin realitetin që është ndryshe, që është përmirësuar goxha, siç e përmendi edhe zonja zëvendësministre. Në këto 14 javët e fundit ne kemi një rënie të konsiderueshme të numrit të rasteve të reja, por, mbi të gjitha, është rënia shumë e madhe e numrit të rasteve spitalore dhe komplikancave dhe kjo na bën shumë optimistë. Nuk duhet të harrojmë se vera është gjithmonë e bukur, por vjen vjeshta dhe ne nuk kemi pse të përballemi me situata jo të dëshiruara, kur mund t’i marrim masat dhe tashmë është një gjë që është ofruar.

Ka një ndryshim të vogël të çmimi për shkak të investimeve në zinxhirin ftohës dhe për shkak të rritjes së jetëgjatësisë të vaksinës, por gjithmonë çmimi mbetet konfidencial, për shkak të marrëveshjes që ne kemi nënshkruar me *Pfizer*-in.

Do t'i ftoj kolegët që edhe ne të jemi iniciatorë në marrjen e nismave kryesisht në shkolla, sepse shikohet që nga prindërit një lloj rezistence për procesin e vaksinimit, ndërsa për grupet e riskut, nga të dhënat e ministrisë, ne jemi shumë mirë në procesin e vaksinimit, por tek të rinjtë dhe fëmijët mbetet akoma punë për të bërë.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolege!

Urdhëroni, zonja Zëvendësministre!

**Vjollca Braho** – Desha të shtoja diçka në lidhje me çmimin. Edhe pse ka një rritje të çmimit, në bazë të bisedimeve dhe të marrëveshjes që është bërë me kompaninë “Pfizer”, çmimi i vaksinave për Shqipërinë është më i vogël se sa në vende të tjera, të cilat kanë marrë furnizime nga kompania “Pfizer”.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

A ka pyetje? Diskutime? Komente?

Urdhëroni, ministrja Gjonaj!

**Etilda Gjonaj** – Në fakt, unë kam një koment, më shumë se sa pyetje, pasi zëvendësministrja dhe kolegja Spahiu i thanë qartësisht ndryshimet që përmbahen në marrëveshje që ka ardhur për t'u diskutuar në këtë komision dhe për t'i kaluar më pas senacës për miratim.

Është për t'i theksuar se në të gjitha format nga qeveria, njëkohësisht edhe nga ministrja e Shëndetësisë, zonja Manastirliu, së bashku me të gjithë strukturat, kanë pasur një objektiv që të gjitha problematikave apo atyre faktorëve, që janë të pashmangshëm për t'u marrë në konsideratë, kanë tentuar që me kontrata apo marrëveshje të tilla t'u dalin përpara dhe besoj kjo marrëveshje që diskutojmë e miratojmë sot është një sinjal shumë i rëndësishëm i vazhdueshmërisë në mënyrë të qëndrueshme të politikave që Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë jo vetëm për pjesën e të gjitha masave lidhur me përballimin e situatës së pandemisë, por edhe për plotësimin me numrin e vaksinave të nevojshme, siç e theksoi edhe kolegja Spahiu, jo vetëm për tani, por edhe për shtatorin e në vijim, kur situata mundet të jetë edhe paksa më e vështirë se sa në periudhën e verës.

Unë do të doja të vlerësoja dhe të falënderoj edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, njëkohësisht jo vetëm për mënyrën sesi e kanë prezantuar këtë projektligj, por, nga

ana tjetër, për të gjitha masat e kujdesshme që kanë marrë për të përballuar situatën e pandemisë në mënyrë të qëndrueshme.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zonja Ministre!

Ky ishte edhe një rast i mirë për të risjellë në vëmendjen e të gjithë qytetarëve nevojën për t'u vaksinuar, sepse kemi ende punë për të bërë. Situata mund të precipitohet ashtu siç edhe në fakt është agravuar në disa vende, siç mund të jetë, për shembull, rasti i një qyteti të madh prej 26 milionë banorësh, si Shanghai, i cili prej më shumë se 10 ditësh është izoluar totalisht. Variante të reja, për fat të keq, mund t'i kemi prezentë. Kështu që, është e nevojshme të vaksinohemi. Kjo është mbrojtja më e mirë që mund të kemi.

Fjala për zotin Shehu.

**Tritan Shehu** – Faleminderit!

Ne jemi dakord në parim, madje i kemi thënë Ministrisë së Shëndetësisë që nuk gjejmë edhe sens që çdo marrëveshje e tillë standarde të kalojë nëpër komisione, sepse realisht mund të bëhet edhe në mënyrë automatike. Është normale dhe nuk ka asnjë pengesë për këtë, përkundrazi ne gjithmonë kemi qenë dakord.

Ndërsa në lidhje me problemet e ecurisë së pandemisë COVID-19, nuk besoj se është vendi për të diskutuar, ka një komision tjetër, që merret drejtpërdrejt me këto çështje.

Unë do të doja të gjendej një mundësi apo mënyrë që të kalojë më lehtësisht pa kaluar çdo hallkë në parlament, pasi janë marrëveshje standarde.

**Mimi Kodheli** – Zoti Shehu, jam plotësisht dakord me ju.

Është e mundur që kur t'i rikthehem sërish Rregullores, disa gjëra realisht mund t'i rregullojmë dhe t'i bëjmë më të zbatueshme dhe praktike.

E hedhim edhe një herë në votim aktin normativ. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Shoh që jeni të gjithë dakord, nuk ka as kundër, as abstenim.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Zonja të nderuara, doktoresha, zëvendësministre, ju falënderoj për prezencën!

Punë të mbarë!

Me krahë të lehta!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 19.04.2022, ora 11.00

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisioni**

**Rendi i ditës:**

Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për një hua të bazuar në politika për mbështetjen e barazisë gjinore në aksesin ndaj mundësive ekonomike në Shqipëri".

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krrashi, Petro Koçi, Tritan Shehu, Klodiana Spahiu, Pandeli Majko, Etilda Gjonaj, Taulant Balla, Bardhyl Kollçaku dhe Grida Duma.

**Mungojnë:**

Tomor Alizoti, Greta Bardeli, Shpëtim Idrizi, Vangjel Dule, Belind Këlliçi dhe Kreshnik Çollaku.

**Të ftuar:**

Olta Manjani – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Kesjana Halili - Drejtore e Drejtorisë së Bashkërendimit dhe Ndihmës së Huaj

Albin Gega – Drejtor i Drejtorisë së Punësimit dhe Aftësimit Profesional

Evis Fico - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

**Mimi Kodheli** – Kalojmë te shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për një hua të bazuar në politika për mbështetjen e barazisë gjinore në aksesin ndaj mundësive ekonomike në Shqipëri".

Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relatore është kolegja Konomi.

Të ftuar për këtë pikë kemi zonjën Manjani, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë.

Mirë se vini, zonja Manjani!

Zonjën Halili e kemi rikthyer në komision. Gjithashtu kemi të pranishëm zotin Gega, drejtor i Drejtorisë së Punësimit dhe Aftësimit Profesional.

Fillojmë me diskutimin e këtij projektligji.

Fjala për zonjën zëvendësministre.

**Olta Manjani** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim në shumën 50 milionë euro. Kjo hua vjen në formën e një mbështetjeje buxhetore, e bazuar në politikat për promovimin e barazisë gjinore për të qëndruar në aksesin ndaj mundësive ekonomike në Shqipëri.

Së pari, ju bëj me dije se kjo hua në shumën prej 50 milionë eurosh është në formën e mbështetjeje buxhetore, që do të thotë se ajo shkon për financimin e përgjithshëm të buxhetit të shtetit dhe deficitit të përgjithshëm të tij.

Reformat e ndërmarra në kuadër të barazisë gjinore në aksesin ndaj mundësive ekonomike janë parakushte për akordimin e kësaj mbështetjeje buxhetore, e cila shkon për të plotësuar nevojat për financim të buxhetit të shtetit.

Programi për mbështetjen e barazisë gjinore në aksesin ndaj mundësive ekonomike në Shqipëri është një program i ndarë në dy faza kryesore të lidhura me disbursimin e transheve të huasë. Masat për realizimin e këtij programi ndiqen nga një sërë institucionesh krahas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Instituti i Statistikave, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë.



Zbatimi i këtyre masave monitorohet nga komiteti drejtues, i kryesuar nga zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, përgjegjës për çështjet sociale, dhe ka në përbërje përfaqësues nga të gjitha institucionet e përmendura më sipër.

Si rezultat i përmbushjes së masave të përcaktuara në matricën e politikave do të mundësohet huaja dhe disbursimi i saj, me qëllim plotësimin e nevojave për financim të buxhetit të shtetit.

Dëshiroj të theksoj se mbulimi i nevojave për financim nëpërmjet mbështetjeve buxhetore është një ndër instrumentet më të favorshëm të financimit, duke qenë se kemi të bëjmë me kredi me terma të buta dhe të akorduara nga institucione ndërkombëtare zhvillimi, si: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Gjermane për Zhvillim, Agjencia Franceze për Zhvillim, si dhe vetë Bashkimi Evropian, institucione këto që mbështesin zhvillimin e vendeve të ndryshme, ndër të cilat është dhe vendi ynë.

Ndër mbështetjet buxhetore më të rëndësishme të akorduara vitet e fundit përmendim mbështetjen buxhetore...

**Mimi Kodheli** – Zonja zëvendësministre, ju kërkoj ndjesë për ndërprerjen!

Relacionin e kemi para, i kemi para edhe efektet financiare. Do të kisha dashur të ishit më shteruese, e para, dhe e dyta, besoj se kjo do të vijë pas pyetjeve dhe diskutimeve të kolegëve, nëse do të ketë një vlerësim të *output*-it apo të produktit që do të dalë nga një hua e konsiderueshme që lidhet me një gjë, që është e vështirë të ketë një vlerësim real, të prekshëm për aq kohë sa flasim për barazinë gjinore.

Do t'ju lutesha të na thoni dy fjalë shteruese lidhur me marrëveshjen, pasi relacioni e kemi para.

**Olta Manjani** – Duke qenë se është një kredi që merret në formën e mbështetjes buxhetore, mënyra si funksionon ky instrument, është një instrument ku i gjithë financimi kalon në buxhetin e shtetit dhe përdoret për qëllime të ndryshme. Ndërkohë, e gjithë mbështetja buxhetore është e shoqëruar edhe me një asistencë teknike, e cila nuk është pjesë e shumës prej 50 milionë eurosh, që kalon në buxhetin e shtetit, e cila përdoret për t'u ardhur në ndihmë të gjitha institucioneve për të përmbushur këto kritere dhe indikatorë për marrjen dhe disbursimin e kësaj kredie.

Kjo është në parim dhe në përgjithësi se si funksionon instrumenti i mbështetjes buxhetore.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Të falënderoj!

Kolegia Konomi, fjala për ju.

**Hatixhe Konomi** - Faleminderit, kryetare!

Ashtu sikurse e dëgjuat edhe nga përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për një hua të bazuar në politikat për mbështetjen e barazisë gjinore në aksesin ndaj mundësive ekonomike në Shqipëri në shumën 50 milionë euro.

Kjo marrëveshje është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me anë të vendimit nr. 1929, në datën 24.12.2020 dhe është nënshkruar ndërmjet palëve më datën 25 nëntor të vitit 2021.

Ashtu sikundër e tha edhe zëvendësministria, kemi të bëjmë me një kredi me terma të butë, të akorduara nga një institucion ndërkombëtar zhvillimi, siç është Agjencia Franceze për Zhvillim, e cila jo vetëm e jep huan me terma të favorshëm në kushtet e tregut, por mundëson, gjithashtu, mbështetje për realizimin e reformave të ndryshme dhe të rëndësishme për zhvillimin e vendit.

Në terma më konkretë, disbursimi i kësaj huaje ka për qëllim përmirësimin e aksesit të grave dhe vajzave tek asetet, rritjen e mundësisë së tregut të punës për gratë dhe vajzat dhe forcimin e masave institucionale për krijimin e politikave të informuara gjinore.

Duke iu referuar INSTAT-it, aktualisht gratë përbëjnë 50,2% të popullsisë gjithsej, me një moshë mesatare 38,6 vite. Po ashtu, të dhënat për vitin akademik 2019-2020 nga 33 mijë studentë të diplomuar në arsimin e lartë, vajzat përbënin 65,3% të të diplomuarve.

Mendoj se janë këto shifra që na bindin edhe më tepër për rëndësinë e programeve me fokus barazinë gjinore. Edhe pse në fakt, prej vitesh Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dhënë mbështetje të vazhdueshme për barazinë gjinore, do të doja të theksoja faktin që ne jemi i vetmi vend në Ballkan që ka përfshirë në ligjin organik të buxhetit edhe buxhetimin gjinor. Rezultatet janë të dukshme në nivelin e integritit të buxhetimit të përgjithshëm gjinor në programin buxhetor afatmesëm, ku numri i programeve buxhetore, që përfshijnë në mënyrë efektive objektivat e lidhura me elementet gjinore, është rritur nga 9 programe në vitin 2015, në 38 të tilla në vitin 2020.

Pa dashur të zgjatem më tepër, sepse, në fund të fundit, jemi komision për dhënie mendimi, dhe jam e sigurt që ky projektligj është diskutuar në Komisionin e Ekonomisë dhe në Komisionin për Çështjet Sociale, do të doja të përmendja disa nisma ligjore në fushën e barazisë gjinore, që kanë qenë realisht rezultative: siç është ligji “Për nxitjen e punësimit”; ndryshimet e Kodit të Punës, që janë në një linjë me legjislacionin e BE-së për të mbështetur barazinë gjinore në tregun e punës, kryesisht të lidhura me rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen e fuqizimit ekonomik të grave në tregun e punës; po ashtu kemi edhe ligjin “Për noterinë”, që është një arritje në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive të grave dhe vajzave; kemi edhe ligjin “Për kadastrën”, që rregullon çështjet e barazisë gjinore lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore; kemi edhe ligjin “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, i cili rregullon veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale ,me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël, duke shënuar një hap drejt barazisë gjinore, pasi këto shërbime lehtësojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës; kemi edhe strategjinë e re të zhvillimit të biznesit dhe të investimeve për vitet 2021-2027, që siguron një mbështetje më të madhe për përmirësimin e klimës së biznesit në tërësi dhe suportin e grave të sipërmarrjes në veçanti.

Në fakt, edhe pse të dhënat e fundit paraqesin një përmirësim në shumë prej indikatorëve të barazisë gjinore, përsëri mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim.

Ndaj do t’ju ftoja të gjithëve që ta mbështesim këtë projektligj.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Të falënderoj, realisht, kolegja Konomi, për të dhënat që solle dhe për seriozitetin me të cilin relaton këtë projektligj!

Hapet diskutimet ose pyetjet.

Zoti Shehu.

**Tritan Shehu** – Faleminderit!

Jam dakord me atë që tha zonja Konomi, që këtu kemi dy optika të ndryshme. Ne jemi Komisioni për Punët e Jashtme, janë komisionet përkatëse që e shohin në një optikë tjetër këtë projektligj dhe nuk mund të jetë e njëjta gjë, por, meqenëse u futëm në disa detaje të elementeve më teknike të projektit, do të doja të thosha se në komision ramë dakord që ta shtyjmë për javën e ardhshme diskutimin. Ministria duhet të na sjellë sqarime të tjera, pasi ne bëjmë një sërë pyetjesh, ku u vendos të diskutohet më pas. Ka diçka, mendoj unë, që nuk i takon komisionit

tonë për diskutim, pasi ne e shohim në tjetër optikë. Janë 50 milionë euro për barazinë gjinore, në fakt 1,5 janë realisht për barazinë gjinore, nga të cilat mendoj se duhet detajuar çështja e noterëve, trajnimi dhe përgatitja e tyre, si dhe elemente të tjera, ndërsa pjesa tjetër është thjesht mbështetje buxhetore.

Diskutimi ishte: pse t'i vëmë këtë emër kur shuma, pothuajse në totalin e saj, është për mbështetjen buxhetore të përgjithshme, që mund të përdoret për çdo gjë që ka nevojë qeveria lidhur me problemet e ndryshme të buxhetit, e lidhur kjo pa dyshim edhe me çështjen e deficitit buxhetor. Madje kolegët diskutuan kur u morën 70 milionë euro nga Eurobond-i, pse duhet t'i shtojmë edhe 50 milionë të tjera. Pra, ky ishte diskutimi që u bë në komision dhe u vendos që të diskutohet në të ardhmen. Këtu, pa dyshim, ka një tjetër optikë të diskutimit, kështu që nuk dua të zgjatem më tej.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Të falënderoj, doktor!

A kanë ndonjë koment zonjat e Ministrisë së Financave lidhur me komentin e zotit Shehu? Nëse nuk keni ndonjë koment thelbësor për të bërë, unë i mbetem plotësisht diskutimit të kolegut Shehu lidhur me optikën apo këndvështrimin me të cilin shikohet apo diskutohet kjo marrëveshje në Komisionin për Politikën e Jashtme. Gjithsesi, ky komision, pavarësisht çështjeve që diskuton, në thelb mbetet sensibil ndaj çështjeve të barazisë gjinore. E para.

E dyta, personalisht do të kisha dashur një informacion më të detajuar lidhur me efektet pozitive si rezultat i të gjithë kësaj pune të bërë për mbështetjen e gjithë strukturave dhe institucioneve që kanë sjellë pastaj një baraspeshë midis burrave dhe grave sa i përket aksesit në tregun e punës, sepse më rezulton, siç mund të rezultojë edhe në vende shumë të zhvilluara të botës, që papunësia ndër gra është më e madhe, gjithmonë, sesa ndër burra; niveli i pagesës për të njëjtën punë është më i ulët sesa ai ndër burra, dhe kjo nuk ndodh vetëm në Shqipëri por edhe në vendet më të zhvilluara perëndimore. Pra, jemi në rrugën e duhur, bëjmë investimet e duhura por duhet të kemi disa të dhëna lidhur me deri më sot se cilat janë rezultatet konkrete, ku kemi qenë, ku jemi dhe ku synojmë të shkojmë.

Thënë kjo, mendoj se duhet të rivlerësojmë faktin se mbështetja buxhetore përkthehet e gjitha në favor të barazisë gjinore apo pjesërisht, apo përdoret për qëllime të tjera të mira.

Gjithsesi, jeni të lutura zonja dhe zotërinj, ato që u ka kërkuar komisioni përgjegjës, mund t'ua sillni edhe anëtarëve të Komisionit të Politikës së Jashtme, në mënyrë që në seancën parlamentare ne të mund të jemi pastaj në diskutimin tonë në një zë.

E dyta, mendoj se nga pikëpamja e përputhshmërisë së këtij projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje të huas me çka komisioni ynë diskuton, ne jemi në rregull, kështu që mund ta kalojmë në parim dhe në tërësi projektligjin, me besimin që ju do të përcillni informacionin që u është kërkuar në komisionin përgjegjës, edhe në komisionin tonë.

Biem dakord kështu?

**Petro Koçi** - Pavarësisht asaj që theksoi zoti Shehu lidhur me orientimin e huas, mendoj se ne nuk kemi mundësi të ndërhyjmë në titullin e marrëveshjes, sepse është një marrëveshje e akorduar. Kjo mbetet një hua e bazuar në politikat për mbështetjen e barazisë gjinore, në aksesin ndaj mundësive ekonomike, pavarësisht se vetë huaja mund të ketë edhe seksione të tjera mbështetëse.

Kështu që ne jemi të detyruar ta kalojmë kështu. Ne jemi Komisioni i Jashtëm dhe shohim me kë bëhet marrëveshja në kuptimin e partneritetit dhe interesave tona. Besoj se është një marrëveshje që merr pëlqimin nga ky komision.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

Ministri Klosi.

**Blendi Klosi** – Do të doja të bëja një shpjegim, kolegë, edhe nga përvoja administrative. Jam në mbështetje të plotë të asaj çfarë vjen nga Ministria e Mirëqenies Sociale, sepse realisht kështu funksionon një mbështetje buxhetore. Ministria e ka parim barazinë gjinore, ashtu sikurse qeveria shqiptare e ka një prioritet të fortë të saj dhe për këtë kemi shembuj të fortë, të cilët duhet t'i përmendim sa herë që flasim për këtë temë.

Pa dyshim, mbështetja buxhetore që vjen në këtë marrëveshje, nuk vjen në një titull të caktuar, por janë mekanizma të caktuar, që bëhen në ligje dhe praktika të ndryshme administrative për mbështetjen me një shumë të caktuar, e cila e lehtëson ministrinë në politikat e saj për të marrë vendime, që në raste të caktuara duket sikur nuk kanë lidhje me barazinë gjinore, por shërbejnë që ministria të ndjekë politikat e saj në sektorë të caktuar, që një nga elementet e veta ka barazinë gjinore. Pra, mbështetja vjen si mbështetje buxhetore në zërin e buxhetit të ministrisë përkatëse, por ministria ka disa targete, për të cilat ka rënë dakord me donatorin, që t'i

ndjekë në kuadër të barazisë gjinore. Mbështetja buxhetore nuk kalon në rast se nuk plotësohen targetet.

Targetet ndoshta nuk kanë shumë lidhje me mbështetjen buxhetore që mendojmë ne, por janë veprime që ka marrë përsipër administrata, qeveria shqiptare dhe pastaj ratifikimi në parlamentin shqiptar, që në realitetin shqiptar do të ndodhin këto veprime, që do të çojnë më pas në miratimin e transheve buxhetore.

Është një praktikë e njohur në administratë dhe unë do të doja shumë që, nëpërmjet zëvendësministres dhe të gjithë stafit të ministrisë, të jepja mbështetje, besoj edhe komisioni nuk ka asnjë cedim në dakordësinë tonë për të mbështetur të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me rritjen e buxhetit për barazinë gjinore. Nuk është një fjalë goje barazia gjinore, por ka veprime të caktuara në fusha dhe elemente të caktuara, që bëjnë pastaj një pazëll më të madh dhe një shtet, i cili e mbështet barazinë gjinore. Besoj ky është edhe ai ngërçi që duhet shpjeguar, që mbështetja buxhetore jepet me këste, në varësi të plotësimit të trageteve që ministria me donatorin kanë rënë dakord dhe tashmë vlerësohet jo vetëm nga administrata shtetërore, por edhe nga donatori sa u përket këtyre trageteve.

Kujtoj këtu një eksperiencë të jashtëzakonshme që kemi pasur në Ministrinë e Mirëqenies me arsimin profesional, ku targetet për mbështetjen buxhetore ishin rreptësisht të kontrolluara nga donatorët dhe që komisione të caktuara vlerësonin çdo element të tyre. Pra, nuk jepen të gjitha për një element, që forcon barazinë gjinore, sepse barazia gjinore është një filozofi që ka nevojë të evidentohet në elemente të ndryshme, që besoj se ministria tashmë edhe mund të na ofrojë indikatorët, që bëjnë kalimin me këste të mbështetjes buxhetore.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zoti Klosi!

Ishit realisht shterues dhe bindshëm cekët një aspekt të rëndësishëm të efekteve, që shpresoj të ketë jo vetëm miratimi i këtij projektligji, por edhe zbatimi i tij. Kështu që, nëse nuk ka komente të tjera, mendoj ta hedhim në votim.

Pra, kalojmë në votimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për një hua të bazuar në politika për mbështetjen e barazisë gjinore në aksesin ndaj mundësive ekonomike në Shqipëri". Ishim komision për dhënie mendimi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me një votë abstenim.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me një votë abstenim.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me një votë abstenim.

E hedhim në votim në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me një votë abstenim.

Ju falënderoj për bashkëpunimin!

Punë të mbarë!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Politikën e Jashtme*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 19.04.2022, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për programin “UKT, shpërndarja e ujit””.

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krrashi, Petro Koçi, Tritan Shehu, Klodiana Spahiu, Pandeli Majko, Etilda Gjonaj, Taulant Balla, Bardhyl Kollçaku dhe Grida Duma.

**Mungojnë:**

Tomor Alizoti, Greta Bardeli, , Shpëtim Idrizi, Vangjel Dule, Belind Këlliçi dhe Kreshnik Çollaku.

**Të ftuar:**

Arbjan Mazniku - Nënkyetar i Bashkisë së Tiranës

Elton Kacidhja - Drejtor i Përgjithshëm i UKT-së

Henrik Hysenbegasi - Drejtor në Drejtorinë e Implementimit të Investimeve të Huaja në UKT

Kesjana Halili – Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë



Elona Mistrovica – Drejtore e Drejtorisë së Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së  
Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Idlir Gjata – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

**Mimi Kodheli** - Atëherë, zonja Halili, unë besoj se duhet të rrini këtu dhe për shkak të diskutimit për projektligjin e fundit që kemi lidhur me UKT-në.

Fillojmë me diskutimin e projektligjit të fundit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për programin “UKT, shpërndarja e ujit””.

Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Ajazi.

Ndërkohë, për të diskutuar për këtë projektligj vjen për pak nga Komisioni i Ligjeve për të relatuar nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, zoti Mazniku. Besoj se do të jenë edhe zoti Kacidhja, drejtor i Përgjithshëm i UKT-së, zoti Hysenbegasi, drejtor në Drejtorinë e Implementimit të Investimeve të Huaja, ndërkohë që kemi kënaqësinë të rikemi pranë nësh zonjën Halili, drejtoreshë e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkëndimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Kështu që, zonja Halili, ju lutem, na thoni dy fjalë për kontratën e huas dhe pastaj ndoshta vijmë përfaqësuesit e Bashkisë së Tiranës, sapo të mbyllin votimin në Komisionin e Ligjeve.

Fjala është për ju.

**Kesjana Halili** – Faleminderit!

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve në shumën 80 milionë euro. Huaja ka si qëllim mbështetjen e programit, që lidhet me shpërndarjen e ujit nga shoqëria aksionere “Ujësjellës- Kanalizime”. Në total financimi i këtij projekti ka vlerën 144,5 milionë euro, ku huaja është 80 milionë euro dhe shuma e investimit, që do të mbulohet nga vetë UKT-ja, është 64,5 milionë euro. Projekti pritet të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës të rreth 300 mijë banorëve të qytetit të Tiranës, duke siguruar furnizim të sigurt dhe të vazhdueshëm me ujë të pijshëm.

Për detaje teknike të projektit besoj do të na flasin zotërinjtë nga Bashkia e Tiranës dhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë.

Për sa u përket termave financiarë të huas, janë 80 milionë euro, me një maturim prej 25 vjetësh, duke përfshirë një periudhë pa pagesë principali prej 5 vjetësh. Ndërkohë, interesi përcaktohet në momentin e disbursimit të huas, në varësi të kushteve të tregut. Këto ishit termat

financiarë të huas. Pra, sikurse e theksova edhe një herë, i gjithë totali i projektit është 144,5 milionë euro, nga këto 80 milionë euro janë kredi dhe 64,5 milionë euro financohen nga UKT-ja.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, drejtoreshë!

Kolegu Ajazi, fjala është për ju, si relator.

**Besion Ajazi** – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Për hyrje, jo si deputet i Partisë Socialiste, por si një banor prej 25-26 vjetësh i qytetit të Tiranës, më duhet ta përhëndes punën e Bashkisë së Tiranës, por edhe ndërmarrjes “Ujësjellës-Kanalizime” për punën e mirë që ka bërë në këto vite, në aspektin e furnizimit dhe shpërndarjes me ujë të pijshëm në të gjithë abonentët e këtij qyteti, që relativisht është goxha i madh.

Për t’iu rikthyer këtij projektligji, si relator më duhet të them që komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe do të ndalem shkurtimisht te ky projektligj, duke thënë që kjo kontratë financiare, që vjen në formën e projektligjit në komisionin tonë, është e bazuar në nenet 78, 83, pikat 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, në përputhje me nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, si dhe me nenin 17 të ligjit nr. 43/2016 ‘Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë’.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për programin “UKT, shpërndarja e ujit”, nëpërmjet së cilës Banka Europiane e Investimeve i akordon këtij projekti një hua në shumën 80 milionë euro.

Projekti “Furnizimi dhe shpërndarja me ujë për Tiranën” ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës të rreth 800 mijë banorëve të qytetit të Tiranës, duke siguruar furnizim të sigurt dhe të vazhdueshëm me ujë të pijshëm, në përputhje me standardet e përcaktuara në direktivën e ujit të pijshëm.

Efektet financiare i shpjegoi përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, ndaj në përfundim të këtij relatimi të shkurtër dua të ftoj kolegët e komisionit ta miratojmë dhe ta votojmë pro.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegut Ajazi!

Ndërkohë, u uroj mirëseardhjen nënkryetarit të Bashkisë Tiranë, zotit Mazniku dhe kolegëve të tjerë.

Mirë se vini, zotërinj!

Zoti Mazniku, e di që jeni pyetur gjatë në Komisionin e Ligjeve, por ju siguroj që këtu ne jemi më shterues në përgjithësi, kështu që i japim vetes të drejtën që disa gjëra t'i bëjmë mirë, por edhe shpejt.

Fjala është për ju, ju lutem, dy fjalë për projektligjin.

**Arbjan Mazniku** – Faleminderit shumë për vëmendjen dhe ju kërkohet ndjesë për vonesën!

Komisioni kishte një seri pyetjesh dhe zgjati përtej parashikimeve. Gjëja më e rëndësishme që duam të shpjegojmë për sa i përket këtij projektligji, është që në thelb kemi të bëjmë me një element financimi për disa nga elementet e një masterplani të madh të zhvillimit të ujit në qytetin e Tiranës. Bashkia e Tiranës ka punuar për rreth 5-6 vjet në mënyrë sistematike me USAID-in, së pari, me Bankën Europiane të Investimeve, së dyti, dhe me kompaninë e ujësjellës-kanalizimeve të qytetit të Budapestit, i cili është një nga qytetet me sistemet më të mira të menaxhimit të ujit në Europë, për të bërë një masterplan të zhvillimit të ujit, që nis nga shtimi i burimeve të ujit për qytetin, të shtimi i kapacitetit përpunues të ujit, të shtimi i kapacitetit transmetues të ujit nga pika e përpunimit drejt qytetit dhe, së fundi, të shtimi apo ristrukturimi nga ana inxhinierike e rrjetit së shpërndarjes së ujit në Tiranë. Rrjeti i shpërndarjes së ujit në Tiranë është një rrjet, i cili ishte krijuar fillimisht për 200 mijë banorë, sepse atëherë qenë popullsia e qytetit të Tiranës përpara 25-30 vjetësh, dhe sot i duhet t'u shërbejë rreth 800 mijë banorëve. Është një rrjet, i cili në mënyrë sistematike është shtuar si rrjet, por pa u ndryshuar thelbësisht nga ana inxhinierike, çka ka sjellë një element problematik, që nga ana e inxhinierëve të ujit quhet "diferenca e madhe e presionit nga pika burimore në pikat fundore të tij".

Duke qenë se rrjeti është në formën e një peme, që të ketë mundësi të shtyhet uji në të gjithë këtë rrjet, ka nevojë të ketë nivel të madh presioni në bazë, çka sjell që në pjesën fillestare të këtij rrjeti të kemi probleme me mbipresionin dhe në pikat fundore ndonjëherë nuk arrijmë dot shërbimin me ujë.

Sidoqoftë, gjatë kësaj kohe mjafton të them që janë bërë një seri investimesh shumë të rëndësishme, duke shtuar sasinë e transmetimit nga liqeni i Bovillës në pikën e përpunimit të ujit, që është në zonën e Zall-Herrit. Aty është duke u punuar tani për dyfishimin e sasisë së përpunimit të ujit, është shtuar kapaciteti transmetues nga pika e përpunimit drejt qytetit dhe sot jemi në një situatë, në të cilën, nëse përpara 6 vjetësh qyteti furnizohej me rreth 9,8 orë mesatarisht me ujë, jemi sot në 17 orë mesatarisht shërbim me ujë. Nëse në atë kohë rreth 5% e

qytetit, më pak se 5% e qytetit merrte ujë 24 orë, sot jemi në një nivel ku 62% e qytetit furnizohet me ujë 24 orë. Sidoqoftë, të dyja këto janë arritje, të cilat ne e kemi të nevojshme t'i përmendim, për të shpjeguar që është bërë shumë punë në këtë fushë, por janë të dyja arritje komplet të pamjaftueshme për sa i përket objektivit thelbësor për të pasur ujë 24 orë për qytetarët.

Ne jemi shumë të qartë që, pavarësisht se kemi lëvizur nga 10 orë në 17 orë, kjo do të thotë shumë pak për qytetarët, të cilët përsëri janë të detyruar të mbajnë depozita me ujë dhe duke mbajtur depozita me ujë, uji është i papijshëm apo i papërdorshëm për konsum në mënyrë të përditshme. Deri në momentin që do të arrijmë të realizojmë ujë të pijshëm për 24 orë për qytetarët dhe t'u japim atyre sigurinë e qëndrueshmërisë së shërbimit, pra uji të vijë gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme dhe t'i bindim të heqin depozitat, atëherë do të kemi mundësi që uji të jetë i pijshëm nga qytetarët.

Investimi në fjalë, që financohet nga Banka Europiane e Investimeve, përfshin dy projekte. Projekti i parë është shtimi i një burimi të ri uji për ujëmbledhësin e Bovillës, që vjen nga zona e Gurit të Bardhë dhe pjesa e dytë është ajo që quhet Unaza e Presionit, që është një tub i madh unazor, që ndjek pak a shumë për ta thjeshtuar për anëtarët e nderuar të komisionit, zonën e unazës së qytetit. Kjo unazë presioni krijon mundësinë që brenda saj të ketë furnizim nga linja të ndryshme, pra edhe nga Bovilla, edhe nga Shën Mëria, edhe nga Selita, të ketë qëndrueshmëri presioni brenda unazës dhe më pas secila prej zonave lidhet me presion të ngjashëm, duke na siguruar mundësinë e ofrimit të ujit të pijshëm 24 orë në të gjithë qytetin e Tiranës. Ky është një investim thelbësor, që na jep mundësinë që në një periudhë 3-4-vjeçare, nga momenti i fillimit të punimeve, ta realizojmë këtë objektiv, i cili ka qenë një objektiv i vjetër për qytetin e Tiranës.

Falënderoj komisionin për trajtimin, veçanërisht qeverinë për faktin që e ka marrë këtë çështje në shqyrtim!

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Realisht të falënderoj për mënyrën e prezantimit të situatës dhe arritjeve që tentojmë të mbërrijmë! E vlerësoj shumë përgatitjen tuaj dhe mënyrën si e prezantuat këtë gjë dhe këtë më duhet ta ritheksoj, sepse nuk ndodh gjithmonë kështu.

Ia kaloj fjalën relatorit dhe pastaj e hap fjalën për komente.

Më falni, relatori foli. Ngaqë ti, Besion the që kam 25 vjet këtu dhe mezi po pres, unë kam 60 vjet këtu në këtë qytet dhe mezi pres të hap rubinetin dhe të pi ujë, siç pinim ujin e famshëm të Selitës, kur ishim fëmijë, me gjithë mungesat e jashtëzakonshme të asaj kohe.

I ftoj kolegët për pyetje ose komente, gjithsesi më lejoni t'ju rikujtoj që ky është një komision, që e diskuton nga një këndvështrim tjetër projektligjin, por uji ngelet një çështje sensitive, jetike për secilin prej nesh.

Fjala është për kolegun Petro.

**Petro Koçi** – Thjesht e mbështesim, është një çështje që ka lidhje edhe me sigurinë, sepse ka lidhje me shëndetin e njerëzve, me mirëqenien e tyre dhe dua të përshëndes të gjithë ata që kanë kontribuar në realizimin e kësaj marrëveshjeje. Natyrisht do të kërkoja, si deputet, të zbatohet me rreptësi të veçantë.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Unë, në vazhdim të asaj që nënkryetari tha, dua ta falënderoj qeverinë në këtë rast për mbështetjen që i jep Bashkisë së Tiranës dhe ndërmarrjes përgjegjëse për zbatimin e projektit, sepse kryeqytetin mezi e kemi, këtu jeton pothuajse gjysma e popullsisë së Shqipërisë, kështu që na duhet t'ia japim këtë shërbim në mënyrën më të mirë të mundshme dhe i ftoj të gjithë ata që na ndjekin të mos e keqpërdorin dhe të mos e shpërdorojnë ujin, sepse, duke e pasur me shumicë, kemi tendencën ta bëjmë këtë.

Kolegë që do të zbatoni këtë projekt, ju lutem të keni parasysh që, e di që e dini, por më duhet ta ritheksoj, uji është një shërbim strategjik, i cili ka të bëjë me sigurinë e jetës së gjithsecilit prej nesh dhe elementet e sigurisë janë gjithmonë elemente të rëndësishme që duhet t'i kemi parasysh.

Thënë kjo, mendoj ta hedhim në votim.

Kush është dakord me projektligjin? Kundër? Nuk ka Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju falënderoj kolegë!

Edhe një herë të votojmë projektligjin në tërësi.

E konsideroj të miratuar.

Kolegë të bashkisë, ju falënderoj shumë për prezencën!

Shpresoj të kemi rikuperuar nga koha që harxhuat në komisionin tjetër, por jam e bindur që ne bëjmë punën e duhur, në cilësinë e duhur dhe me kohën e mjaftueshme për t'i tejçuar detyrat tona me sukses deri në fund.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

**Arbjan Mazniku** – Zonja kryetare, faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit juve!

## **MBYLLET MBLEDHJA**